


KËRKESË ANKIMORE – PËRPARA K.A.S

Tiranë – Datë 28.04.2025



ANKUESI	
Subjekti Ankues	Adresa, posta elektronike dhe/ose nr. i telefonit : Selia e PD, Bulevardi "Zhan d'Ark", Nr. 11, Tiranë. Tel: 0697839115
SUBJEKTI "PARTIA DEMOKRATIKE – ALEANCA PËR SHQIPËRINË MADHËSHTORE" (PD-ASHM)	
<u>OBJEKTI I ANKIMIT</u>	
1) Kundërshtimi i Vendimit të KSHZ, Për mos-pranimin e kërkesës së PD-ASHM lidhur me shkarkimin e anëtarit të KZAZ nr. 93 znj. Eva UZEIR dhe Sekretarit të KZAZ nr. 93, z. Julian LAKO, vendimmarrje ardhur në dijeninë tonë me anë të shkresës "Kthim përgjigje, Nr. Prot., 2996/2, datë 25.04.2025 ;	
2) Ndryshimi i vendimit të KSHZ, duke urdhëruar shkarkimin e anëtarit të KZAZ nr. 93 znj. Eva UZEIR dhe Sekretarit të KZAZ nr. 93, z. Julian LAKO.	
Vendimi	<u>TITULLI I VENDIMIT</u> Për mos-pranimin e kërkesës së PD-ASHM lidhur me shkarkimin e anëtarit të KZAZ nr. 93 znj. Eva UZEIR dhe Sekretarit të KZAZ nr. 93, z. Julian LAKO, vendimmarrje ardhur në dijeninë tonë me anë të shkresës "Kthim përgjigje, Nr. Prot., 2996/2, datë 25.04.2025
Nr.	Datë
S'ka	25.04.2025
1. "Për zj. Eva Uzeir, ju bëjmë me dije se ka marrë leje nga institucioni ku është punësuar prane Bashkise Konispol ;	
2. Per z. Julian Lako, ju bejme me dije se KSHZ nepermjet shkreses 3229, date 23.04.2025 i ka terhequr vemendjen (...) per mungesen e kujdesit te treguar ne permbushjen e detyres ..."	
Baza Ligjore: Nenet: 3, 8, 21, pika 1, gërma "a", neni 26 pika 2, neni 32, nenet 33, 34, 35, 123/1, 123/3, 124, 124/1, 125, 126, 127, 128, 129, 130, 131, 133, 134 e vijues të ligjit Nr. 10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", i ndry, shuar.	

NË LIDHJE ME PROCEDURËN DHE KONTESTIMIN

A. Në lidhje me legjitimitimin e palës ankuese

Zgjedhjet për Kuvend u caktuan në datën 11 Maj 2025, me dekretin e Presidentit të Republikës.



- Me Vendimin perkates, KQZ regjistroi subjektin zgjedhor "Partia Demokratike", si subjekt zgjedhor për zgjedhjet për Kuvend, të datës 11 Maj 2025" ;

- Me Vendimin perkates, KQZ regjistroi subjektin zgjedhor, "PARTIA DEMOKRATIKE – ALEANCA PËR SHQIPËRINË MADHËSHTORE" (PD-ASHM)", te kryesuar nga Partia Demokratike (PD), për regjistrimin si subjekt zgjedhor në zgjedhjet e pjesshme për Kryetar të Bashkisë Himarë të datë 4 gusht 2024.

Neni 32 i Kodit Zgjedhor parashikon se:/

Shkarkimi dhe lirimi i anëtarëve dhe i sekretarit të KZAZ-së


1. Anëtari dhe sekretari i KZAZ-së shkarkohen nga detyra me vendim të KQZ-së kur:
 - a) shkelin dispozitat e këtij Kodi ose të akteve nënligjore në zbatim të tij lidhur me detyrat e KZAZ-së;
 - b) dënohen me vendim gjyqësor të formës së prerë për kryerjen e një krimi;
 - c) mungojnë pa shkaqe të arsyeshme për më shumë se tri mbledhje rresht të KZAZ-së, ose në periudhën zgjedhore nuk paraqiten në detyrë pa shkaqe të arsyeshme për më shumë se 2 ditë rresht; ose
 - ç) nuk marrin pjesë në trajnimet ose nuk kalojnë testimet e organizuara nga KQZ-ja.
2. Anëtarët dhe sekretari i KZAZ-së lirohen nga detyra me vendim të KQZ-së kur:
 - a) kanë marrëdhënie krushqie të afërt ose gjinie deri në shkallë të katërt me ndonjërin nga kandidatët që konkurrojnë në zonë;
 - b) janë në marrëdhënie pune me ndonjërin prej kandidatëve të përfshirë në listën shumemërore të një partie apo koalicioni që konkurren në zonë;
 - c) nuk plotësojnë më kushtet për të qenë zgjedhës;
 - ç) nuk kanë më vendbanimin e tyre në zonën zgjedhore;
 - d) subjekti zgjedhor që i ka propozuar kërkon zëvendësimin e tyre.
3. Anëtari dhe sekretari i KZAZ-së lirohen/shkarkohen nga detyra nga KQZ-ja, kryesisht ose me propozim të subjekteve zgjedhore, vetëm për shkaqet e parashikuara në këtë nen. Në çdo rast, kërkesa për lirim ose shkarkim duhet të përmbajë edhe argumente dhe fakte për shkëlqen e pretenduar. Në rastin e parashikuar në shkronjën "d" të pikës 2 të këtij neni ky rregull nuk zbatohet dhe kërkesa pranohet në çdo rast.

Neni 33 i Kodit Zgjedhor parashikon se:

Detyrat e KZAZ-së

KZAZ-ja kryen këto detyra:

- a) përgjigjet për administrimin dhe zhvillimin e zgjedhjeve në ZAZ, sipas dispozitave të këtij Kodi dhe akteve nënligjore të nxjerra nga KQZ-ja;
- b) emëron kryetarin, zëvendëskryetarin, anëtarët, sekretarët e KQV-ve, dhe anëtaërt e grupeve të numërimit, të përfshira në juridiksionin e ZAZ-së, sipas këtij Kodi;
- c) regjistron në Librin e Protokollit të Mbledhjeve dhe, sipas rastit, verifikon informacionet ose pretendimet e subjekteve zgjedhore në zonë;
- ç) afishon në një vend të dukshëm listat përfundimtare të zgjedhësve, dekretin për caktimin e datës së zgjedhjeve dhe të dhëna të tjera, që lidhen me zhvillimin e zgjedhjeve në zonë;
- d) administron buxhetin e caktuar nga KQZ-ja;
- dh) garanton shpërndarjen në kohë të materialeve të votimit;
- e) merr në dorëzim nga KQV-të materialet e votimit dhe kutitë e votimit;
- ë) përgatit dhe miraton tabelën përmbledhëse të rezulttit të zgjedhjeve për çdo subjekt zgjedhor në ZAZ dhe ia dërgon atë KQZ-së, së bashku me materialet e tjera të nevojshme, në përputhje me nenin 122 të këtij Kodi;
- f) regjistron subjektet zgjedhore dhe kandidatët për zgjedhjet e organeve të qeverisjes vendore;
- g) shpall kandidatët fitues për kryetar të njësisë vendore.



Neni 34 i Kodit Zgjedhor parashikon se:

Detyrat e sekretarit të KZAZ-së:

- a) përgjigjet për administrimin teknik dhe kushtet e punës së KZAZ-së;
- b) protokollon kërkesat, ankesat dhe njoftimet drejtuar KZAZ-së;
- c) mban dokumentacionin zgjedhor të arkivuar;
- ç) përgatit, në përputhje me udhëzimet e kryetarit, materialet për mbledhjen e KZAZ-së dhe ua shpërndan ato anëtarëve;
- d) mban procesverbalet e mbledhjeve të KZAZ-së;
- dh) kryen zbardhjen e vendimeve të marra nga KZAZ-ja dhe i vulos ato;
- e) regjistron në protokoll vendimet e KZAZ-së dhe ua përcjell ato menjëherë subjekteve të interesuara;
- ë) u jep subjekteve zgjedhore ose personave të tretë, pa pagesë dhe brenda 24 orëve nga paraqitja e kërkesës, kopje të vërtetuara të vendimeve të KZAZ-së ose procesverbaleve të mbledhjeve të tyre;
- f) regjistron në protokoll marrjen në dorëzim të materialeve zgjedhore të dërguara nga KQZ-ja, sipas nenit 99 të këtij Kodi dhe përgjigjet për administrimin dhe ruajtjen e tyre, në përputhje me kërkesat e këtij Kodi;
- g) me kërkesë të zgjedhësve, lëshon vërtetime nëse emri i zgjedhësit gjendet ose jo në listat përfundimtare të zgjedhësve në zonën përkatëse të administrimit zgjedhor;
- gj) regjistron në protokoll vërejtjet që vëzhguesit i paraqesin komisionit;
- h) bashkërendon me Policinë e Shtetit masat për rendin publik në funksion të zgjedhjeve, si dhe administron dokumentacionin zyrtar për ndërhyrjet e policisë në rivendosjen e rendit publik, kur jashtë qendrës së votimit rrezikohet rendi ose pengohet procesi i rregullt i votimit.

Neni 35 i Kodit Zgjedhor parashikon se:

Mbledhjet dhe vendimet e KZAZ-së

1. Mbledhjet e KZAZ-së janë publike.
2. Mbledhjet e KZAZ-së janë të vlefshme kur në to marrin pjesë shumica e të gjithë anëtarëve të KZAZ-së. Vendimet e KZAZ-së merren me shumicën e votave të të gjithë anëtarëve të KZAZ-së. Sekretari nuk ka të drejtë vote.
3. Vendimet e KZAZ-së nënshkruhen nga të gjithë anëtarët që kanë marrë pjesë në votim. Secili prej anëtarëve të komisionit, krahas nënshkrimit të tij në vendim, deklaron votën “pro” ose “kundër”, si dhe arsyetimin përkatës.
4. Vota e anëtarëve që janë në kushtet e konfliktit të interesit, të parashikuar në nenin 32 pika 2 të këtij Kodi dhe nuk janë liruar nga detyra, sipas atij neni, është e pavlefshme dhe nuk llogaritet në kuorum.
5. Në rast se KZAZ-ja nuk arrin të marrë vendim brenda afatit përkatës, çështja i dërgohet brenda 24 orëve për shqyrtim KQZ-së nga kryetari i KZAZ-së ose të paktën nga dy anëtarë, ose mund të ankimohet në KQZ nga subjekti zgjedhor i interesuar. Vendimi i KQZ-së është i detyrueshëm për t’u zbatuar nga KZAZ-ja.

Ne keto kushte, PD-ASHM ploteson kushtin e pare te legjitimitetit juridiko-formal.

B. Në lidhje me kompetencën e organit administrativ



Neni 12, pika 5e Kodit Zgjedhor parashikon se Komisioni i Ankimeve dhe Sanksioneve (në vijim KAS) është organi kompetent për shqyrtimin e ankimeve administrative.

Me Vendimin objekt ankimi nuk eshte marre ne konsiderate kerkesa jone per shkarkimin e dy anterave te KZAZ nr. 93 nga KSHZ. Ne keto kushte, PD-ASHM përmbush kriterin e dytë procedural, kompetencën lëndore, për shqyrtimin e këtij ankimi ne KAS.

C. Në lidhje me afatin e paraqitjes së ankimit

Kriteri i tretë për paraqitjen e një ankimi administrativ në KAS ka të bëjë me afatin ligjor të ankimimit. Për këto raste ne jemi brenda afatit ligjor.

Refuzimi i veprimit administrativ të kërkuar nga ana jone, na është komunikuar zyrtarisht në mbremjen e datës 25 Prill nepermjet shkresës në fjalë, objekt shqyrtimi.

Data e paraqitjes së ankimit në KAS mban datën 28 Prill 2025.

Në rastin konkret, gjykojmë se ankimi i paraqitur ka ardhur brenda afatit 3-ditor të parashikuar nga dispozitat perkatese të Kodit Zgjedhor. Në këtë kuptim, PD-ASHM përmbush kriterin e tretë procedural, afatin ligjor, për paraqitjen e këtij ankimi.

Konkluzion: Neni 130 i Kodit Zgjedhor përcakton se KQZ merr vendim për pranimin e kërkesës ankimore, pasi verifikon: a) kompetencën e KQZ-së; b) legjitimitimin e ankuesit; dhe c) respektimin e afateve ligjore. Duke qenë se sic kemi shpjeguar më lart, ankimi i paraqitur nga BF përmbush të tre kriteret proceduriale (*legjitimitimin, kompetencën dhe afatin ligjor*), kërkojmë nga Komisioni i Ankimeve dhe Sanksioneve kalimin për shqyrtim të kërkesës ankimore të paraqitur nga subjekti zgjedhor PD-ASHM lidhur rastin konkret të paraqitur për shqyrtim nga KAS.

PËRSHKRIMI I SHKELJES SË PRETENDUAR

Siç e cituam edhe në krye të herës, PD-ASHM ka paraqitur kërkesë në KQZ për shkarkimin nga detyra e dy anetareve të KZAZ nr. 93 në Konispol, perkatesisht për znj. Eva UZEIR, anetare, dhe për z. Julian LAKO, sekretar të KZAZ nr. 93, për shkak se ka rënë në dijeni të fakteve dhe rrethanave të cilat, normalisht, nuk do duhet të anashkaloheshin nëqëleshtesisht nga ana e KQZ. Behet fjalë për dy raste teper shqetësuese, ku rasti i parë ka të bëjë me humbjen e vules së KZAZ nr. 93 dhe për ruajtjen e vules pergjegjese si Sekretari i saj. Rasti i dytë ka të bëjë me ekzistencën e konfliktit të interesit teanetares së KZAZ nr. 93, Eva UZEIR. Kjo e fundit ushtron funksionin e pergjegjese së gjendjes civile në Bashkinë Konispol.

Tej faktit se zonja Yzeir ka qenë ajo që ka pergatitur listat e zgjedhësve të asaj zone, si pergjegjese e gjendjes civile, tashmë me detyrën e anetares së KZAZ ajo ka serish rol në procesin zgjedhor dhe gjykojmë se edhe ky fakt perben konflikt të interesit. Po ashtu, kjo shtetase duke qenë e punësuar në Administratën publike, duhet të ishte pezulluar sa kohë ushtron edhe detyrën e anetares së KZAZ nr. 93, si dhe gjykojmë se duhet të kishte deklaruar konfliktin e interesit.

Sa i takon rastit të z. Julian LAKO, theksojmë se konkretisht, Sekretari i KZAZ është pergjegjes për vullen e këtij organi.

Rezulton se vula e kësaj KZAZ të ketë “humbur” dhe se për këtë fakt është bërë edhe denoncimi perkates në organet kompetente. Për humbjen e vules së KZAZ Sekretari i KZAZ z. Lako ka të pakten pergjegjese administrative, (si dhe duhet verifikuar nëse ka apo jo pergjegjese edhe penale), për me teper që ajo vule nuk ishte përdorur asnjehere, sipas informacioneve që na u bënë me dije.

Një fenomen i ngjashëm, teper i rrezikshëm për mbarevajtjen e zgjedhjeve, për krahasim, ndodhi me vull në KZAZ tjetër aty pranë, në Dropull, ku serish u konstatua humbje e vules së KZAZ, por në atë rast në media u bë me dije lajmi i nisjes së hetimeve penale ndaj Sekretarit të asaj KZAZ. Do të duhet që KQZ të na sqarojë nëse ka patur kalëzim apo nisje hetimesh nga ana e organit të prokurorisë edhe për z. LAKO.



Nese per humbjen e vules KQZ jep si sanksion vetem terheqjen e vemendjes, nderkohe nga ana tjeter keto raste apo te ngjashme nisin hetime penale, kjo nuk duket nje shtate proporciale.

Ne vijim, po analizojme te faktet, argumentat dhe dispozitat ligjore ku mbeshetet ankimi.

FAKTET, ARGUMENTAT, DISPOZITAT LIGJORE KU MBËSHTETET ANKIMI.

Referuar Nenit 34 te K. Zgjedhor parashikon se:

Detyrat e sekretarit të KZAZ-së:

- a) përgjigjet për administrimin teknik dhe kushtet e punës së KZAZ-së;
- b) protokollon kërkesat, ankesat dhe njoftimet drejtuar KZAZ-së;
- c) mban dokumentacionin zgjedhor të arkivuar;
- ç) përgatit, në përputhje me udhëzimet e kryetarit, materialet për mbledhjen e KZAZ-së dhe ua shpërndan ato anëtarëve;
- d) mban procesverbalet e mbledhjeve të KZAZ-së;
- dh) kryen zbardhjen e vendimeve të marra nga KZAZ-ja dhe i vulos ato;
- e) regjistron në protokoll vendimet e KZAZ-së dhe ua përcjell ato menjëherë subjekteve të interesuara;
- ë) u jep subjekteve zgjedhore ose personave të tretë, pa pagesë dhe brenda 24 orëve nga paraqitja e kërkesës, kopje të vërtetuara të vendimeve të KZAZ-së ose procesverbaleve të mbledhjeve të tyre;
- f) regjistron në protokoll marrjen në dorëzim të materialeve zgjedhore të dërguara nga KQZ-ja, sipas nenit 99 të këtij Kodi dhe përgjigjet për administrimin dhe ruajtjen e tyre, në përputhje me kërkesat e këtij Kodi;
- g) me kërkesë të zgjedhësve, lëshon vërtetime nëse emri i zgjedhësit gjendet ose jo në listat përfundimtare të zgjedhësve në zonën përkatëse të administrimit zgjedhor;
- gj) regjistron në protokoll vërejtjet që vëzhguesit i paraqesin komisionit;
- h) bashkërendon me Policinë e Shtetit masat për rendin publik në funksion të zgjedhjeve, si dhe administron dokumentacionin zyrtar për ndërhyrjet e policisë në rivendosjen e rendit publik, kur jashtë qendrës së votimit rrezikohet rendi ose pengohet procesi i rregullt i votimit.

Të gjitha faktet, indicjet dhe provat në disponimin tonë, provojnë në mënyrë të qartë dhe të pakundërshtueshme se kemi të bëjmë me shkelje të dispozitave të Kodit Zgjedhor nga ana e Sekretarit të KZAZ z. Lako, si dhe i znj. YZEIR.

Neni 32 i Kodit Zgjedhor parashikon se:/

Shkarkimi dhe lirimi i anëtarëve dhe i sekretarit të KZAZ-së

1. Anëtari dhe sekretari i KZAZ-së shkarkohen nga detyra me vendim të KQZ-së kur:

- a) shkelin dispozitat e këtij Kodi ose të akteve nënligjore në zbatim të tij lidhur me detyrat e KZAZ-së;
 - b) dënohen me vendim gjyqësor të formës së prerë për kryerjen e një krimi;
 - c) mungojnë pa shkaqe të arsyeshme për më shumë se tri mbledhje rresht të KZAZ-së, ose në periudhën zgjedhore nuk paraqiten në detyrë pa shkaqe të arsyeshme për më shumë se 2 ditë rresht; ose
 - ç) nuk marrin pjesë në trajnimet ose nuk kalojnë testimet e organizuara nga KQZ-ja.
2. Anëtarët dhe sekretari i KZAZ-së lirohen nga detyra me vendim të KQZ-së kur:



- a) kanë marrëdhënie krushqie të afërt ose gjinie deri në shkallë të katërt me ndonjërin nga kandidatët që konkurrojnë në zonë;
- b) janë në marrëdhënie pune me ndonjërin prej kandidatëve të përfshirë në listën shumemërore të një partie apo koalicioni që konkurron në zonë;
- c) nuk plotësojnë më kushtet për të qenë zgjedhës;
- ç) nuk kanë më vendbanimin e tyre në zonën zgjedhore;
- d) subjekti zgjedhor që i ka propozuar kërkon zëvendësimin e tyre.

3. Anëtari dhe sekretari i KZAZ-së lirohen/shkarkohen nga detyra nga KQZ-ja kryesisht ose me propozim të subjekteve zgjedhore, vetëm për shkaqet e parashikuara në këtë nen. Në çdo rast, kërkesa për lirim ose shkarkim duhet të përmbajë edhe argumente dhe fakte për shkeljen e pretenduar. Në rastin e parashikuar në shkronjën “d” të pikës 2 të këtij neni ky rregull nuk zbatohet dhe kërkesa pranohet në çdo rast.

Siç e kemi theksuar edhe në fillim, Partia Demokratike – Aleanca për Shqipërinë Madhështore (PD-ASHM) ka paraqitur në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) kërkesat për shkarkimin nga detyra të dy anëtarëve të KZAZ nr. 93 në Konispol, konkretisht znj. Eva Uzeir, anëtare, dhe z. Julian Lako, sekretar i kësaj KZAZ-je, për shkak të fakteve dhe rrethanave serioze, të cilat nuk duhej të ishin anashkaluar me kaq lehtësi nga ana e KQZ-së.

Bëhet fjalë për dy raste tepër shqetësuese:

- **Në rastin e parë,** kemi të bëjmë me humbjen e vulës së KZAZ nr. 93, për të cilën përgjegjësinë kryesore e mban Sekretari i KZAZ-së, z. Julian Lako. Sipas nenit 34 të Kodit Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë, sekretari i KZAZ “përgjigjet për administrimin teknik dhe kushtet e punës së KZAZ-së” dhe njëkohësisht “për administrimin dhe ruajtjen e materialeve zgjedhore të ardhura nga KQZ”. Vula e KZAZ-së është pa dyshim një ndër materialet më të rëndësishme zyrtare që dërgohet nga KQZ dhe që merret në dorëzim zyrtarisht nga sekretari.

Në këtë kuptim, humbja e vulës nuk mund të konsiderohet një çështje e zakonshme apo e justifikueshme. Lindin pyetje thelbësore që nuk mund të anashkalohej: **Si është e mundur të humbet vula? Si mund të dalë vula jashtë zyrave të KZAZ-së pa një qëllim të përcaktuar? Si mundet që vula të hidhet në kosh, rastësisht apo aksidentalisht?** Humbja e një materiali të tillë thelbësor komprometon sigurinë dhe integritetin e procesit zgjedhor. Për këtë arsye, përveç përgjegjësisë së pashmangshme administrative të z. Lako, është e nevojshme të verifikohet edhe ekzistenca e përgjegjësisë penale për këtë ngjarje.

Duhet të theksohet se një situatë e ngjashme ndodhi edhe në një KZAZ tjetër në zonën e Dropullit, ku humbja e vulës solli nisjen e hetimeve penale ndaj sekretarit përkatës. Në këtë kontekst, kërkojmë që KQZ të sqarojë nëse ndaj z. Lako është paraqitur kallëzim penal ose janë nisur hetime nga organet e drejtësisë.

Nëse për humbjen e vulës KQZ aplikon vetëm një masë disiplinore të lehtë, siç është tërheqja e vëmendjes, ndërkohë që në raste të tjera të ngjashme është iniciuar ndjekja penale, atëherë kemi të bëjmë me një situatë të trajtimit të pabarabartë dhe disproporcional.

- **Në rastin e dytë,** konstatohet një situatë e pastër konflikti interesi që lidhet me anëtarin e KZAZ-së znj. Eva Uzeir. Ajo mban funksionin e Përgjegjëses së Gjendjes Civile pranë Bashkisë Konispol, dhe si e tillë, ka qenë përgjegjëse për përgatitjen e listave të zgjedhësve për zonën përkatëse. Krahas kësaj, në rolin e anëtares së KZAZ-së, znj. Uzeir ka ndikim të drejtëpërdrejtë në administrimin e procesit zgjedhor, duke ndikuar potencialisht në integritetin e procesit.

Ky përplasje funksionesh përbën konflikt interesi në kuptim të ligjit, dhe për më tepër, znj. Uzeir si punonjëse e administratës publike duhej të ishte pezulluar nga detyra gjatë periudhës së angazhimit në KZAZ, si dhe kishte për detyrim të deklaronte konfliktin e interesit.



Në vijim të kësaj kërkesë, do të analizojmë në mënyrë të detajuar faktet, argumentet dhe dispozitat ligjore mbi të cilat mbështetet ankimi ynë.

Për sa i përket këtyre shkeljeve,

Në vlerësimin tonë ka prova të mjaftueshme për të disponuar sipas objektit të kërimit.

Sa më sipër kërkojmë:


- 1) Kundërshtimi i Vendimit të KSHZ, Për mos-pranimin e kërkesës së PD-ASHM lidhur me shkarkimin e anëtarit të KZAZ nr. 93 znj. Eva UZEIR dhe Sekretarit të KZAZ nr. 93, z. Julian LAKO, vendimmarrje ardhur në dijeninë tonë me anë të shkresës “Kthim përgjigje, Nr. Prot., 2996/2, datë 25.04.2025 ;
- 2) Ndryshimi i vendimit të KSHZ, duke urdhëruar shkarkimin e anëtarit të KZAZ nr. 93 znj. Eva UZEIR dhe Sekretarit të KZAZ nr. 93, z. Julian LAKO.

**PROVAT QË PARAQITEN
DHE /OSE KËRKOHEN, BURIMIN SI DHE NUMRI I TYRE**

1. Kopje e Njoftimit nga KSHZ lidhur me mosmarrjen e masave administrative të kërkuara nga ana jone ;

**Përfaqësuesi Ligjor i Subjektit
“PARTIA DEMOKRATIKE – ALEANCA PËR SHQIPËRINË MADHËSHTORE” (PD-ASHM)**

z. Franci NURI


Tiranë, 25/04/2025





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE
KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Tiranë më 25.4.2025

Nr. 2996/2 Prot.

Lënda: Kthim përgjigje

Drejtuar: Z. Franci Nuri

Përfaqësues ligjor pranë KQZ për Koalicionin PD – ASHM

I nderuar z. Nuri,

Në përgjigje të shkresës suaj më datë 15.04.2025, administruar pranë Komisioni Qendror i Zgjedhjeve me nr. 2996/1 Prot., datë 15.04.2025, nëpërmjet së cilës kërkon shkarkimin e një anëtar, zj. Eva Uzeir dhe sekretarit z. Julian Lako të KZAZ-së nr. 93 për mosrespektimin e detyrave zyrtare për konflikt interesi dhe mosadministrimin e duhur sipas dispozitave të Kodit Zgjedhor për humbjen e vulës, ju informojmë si më poshtë vijon:

- Për zj. Eva Uzeir ju bëjmë më dije ka marrë leje nga institucioni ku është i punësuar pranë Bashkisë Konispol, për të marrë pjesë në mbledhjet dhe aktivitetet e KZAZ-së, sa herë që kjo është e nevojshme. Leja është dhënë në përputhje me kërkesat ligjore.
- Për z. Julian Lako ju bëjmë më dije së Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve nëpërmjet shkresës 3229, datë 23.04.2025 i ka tërhequr vëmendjen sekretarit të KZAZ nr. 93, qarku Vlorë, për mungesën e kujdesit të treguar në përmbushjen e detyrës dhe kërkohet që të merren masa për ruajtjen dhe administrimin e materialeve të KZAZ-së, në mënyrë që të shmanget përsëritja e një situate të tillë në vijim të këtij procesi zgjedhor.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin,

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI






Partia
Demokratike

KOALICIONI

PARTIA DEMOKRATIKE – ALEANCA PËR SHQIPËRINË MADHËSHTORE

Tiranë, më 15 Prill 2025



Lënda: Kërkesë për shkarkimin e dy anëtarëve të Komisionit Zonal të Administrimit Zgjedhor (KZAZ) nr. 93 Konispol për mosrespektimin e detyrave zyrtare, për konflikt interesi dhe mosadministrimin e duhur, sipas dispozitave të nenit 30, 32 dhe 34 të Kodit Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë, në kontekstin e humbjes së vulës zyrtare më 14 prill 2025

Kerkues: Koalicioni Partia Demokratike – Aleanca për Shqipërinë Madhështore (PD-ASHM), Përfaqësuar nga Z. Franci Nuri, Përfaqësues Ligjor pranë KQZ-së i PD-ASHM Pranë Partisë Demokratike, Bulevardi Zhand d'Ark, nr. 11, Tiranë, email: pd@rithemelimi.com

Baza Ligjore: Kodi Zgjedhor i RSH;

Drejtuar: Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), përfaqësuar nga Z. Celibashi Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) Sheshi Skënderbej, Nr. 1, Tiranë, Shqipëri

Të nderuar/a përfaqësues/e i KQZ-së,

Ne, Koalicioni Partia Demokratike-Aleanca për Shqipërinë Madhështore (PD-ASHM), të përfaqësuar nga Z. Franci Nuri, Përfaqësues Ligjor pranë KQZ-së i PD-ASHM, paraqesim kërkesën tonë për shkarkimin e dy anëtarëve të Komisionit Zonal të Administrimit Zgjedhor (KZAZ) nr. 93 Konispol, duke u bazuar te të dhënat dhe situata faktike që kanë nxjerrë në pah mosadministrimin e duhur, konfliktin e interesit dhe mungesën e masave të sigurisë, çka ka çuar në humbjen e vulës zyrtare më datë 14 prill 2025.

I. Fakte dhe Shkaqe

1. Uva Uzeir – Nënkyetare e KZAZ-së nr. 93

• Pozicioni dhe funksionet:

Uva Uzeir, anëtare e Partisë Socialiste, ushtron njëkohësisht funksionin Përgjegjëse në Gjendjen Civile në Bashkinë Konispol.

• Konflikti i interesit:

Ushtrimi i dy funksioneve pa pezullimin e përkohshëm nga administrata publike krijon konflikt të qartë interesi, me rrezik për integritetin e procesit zgjedhor.

Uva Uzeir nuk ka deklaruar konfliktin e interesit i cili lidhet me faktin se ajo ushtron njëkohësisht funksionin Përgjegjëse në Gjendjen Civile në Bashkinë Konispol.

Uva Uzeir kishite detyrimin ligjor për të plotësuar dhe deklaruar se nuk ndodhet në kushtet e konfliktit të interesit, bazuar në modelin e Deklaratës së Vetëdeklarimit për Mosekzistencën e Konfliktit të Interesit, model i cili është kusht paraprak për tu plotësuar dhe dorëzuar që në momentin e aplikimit për këtë pozicion.

Në këtë rast, dyshojmë se ekzistojnë dy skenarë;

1. Uva Uzeir nuk ka deklaruar konfliktin e interesit në këtë model dhe ka vepruar në shkelje të ligjit
2. Uva Uzeir ka deklaruar konfliktin e interesit dhe kjo është pranuar në heshtje nga persona të tjerë që kanë shqyrtuar aplikimin e saj, po ashtu në shkelje të ligjit.

Në të dyja këto raste, Uva Uzeir ndodhet në kushtet e ekzistencës së konfliktit të interesit dhe në shkelje të ligjit.

2. Julian Lako – Sekretar i KZAZ-së nr. 93 dhe Nënkretar i Bashkisë Konispol

• Pozicioni dhe funksionet:

Mbante përgjegjësinë për ruajtjen e vullës zyrtare.

• Mosadministrimi i duhur:

Humbya e vullës më 14 prill 2025 tregon mungesë të masave të duhura për ruajtje dhe administrim të dokumentacionit zgjedhor.

II. Baza Ligjore dhe Shkakët e Shkakimit:

• Neni 30 i Kodit Zgjedhor

Papajueshmëritë me detyrën e anëtarit dhe të sekretarit të KZAZ-së

Anëtarit dhe sekretarit i KZAZ-së nuk mund të jenë:

- a) deputet ose kandidat për deputet në Kuvend;
- b) kryetar të bashkive;
- c) ushtarakë, punonjës të strukturave të Policisë së Shtetit ose të Shërbimit Informativ Shtetëror, ose
- d) anëtar apo sekretar të një komisioni tjetër zgjedhor.

• Neni 32 i Kodit Zgjedhor

Shkakimi dhe lirimi i anëtarëve dhe i sekretarit të KZAZ-së

1. Anëtarit dhe sekretarit i KZAZ-së shkarkohen nga detyra me vendim të KQZ-së kur:

a) *shkelin dispozitat e këtij Kodi ose të akteve nënligjore në zbatim të tij lidhur me detyrat e KZAZ-së;*

b) dënohen me vendim gjyqësor të formës së prerë për kryerjen e një krimi;

c) mungojnë pa shkak të arsyeshme për më shumë se tri mbledhje rresht të KZAZ-së, ose në periudhën zgjedhore nuk paraqiten në detyrë pa shkak të arsyeshme për më shumë se 2 ditë rresht, ose

d) nuk marrin pjesë në trajnimet ose nuk kalojnë testimet e organizuara nga KQZ-ja.

2. Anëtarët dhe sekretarit i KZAZ-së lirohen nga detyra me vendim të KQZ-së kur:

a) kanë marrëdhëniet krushqie të afërt ose gjinie deri në shkallë të katërt me ndonjërin nga kandidatët që konkurrojnë në zonë;

b) janë në marrëdhëniet pune me ndonjërin prej kandidatëve të përfshirë në listën shumëmërore të një partie apo koalicioni që konkurron në zonë;

c) nuk plotësojnë më kushtet për të qenë zgjedhës;

d) nuk kanë më vendbanimin e tyre në zonën zgjedhore;

d) subjekti zgjedhor që i ka propozuar kërkon zëvendësimin e tyre.

• Neni 34 i Kodit Zgjedhor

Detyrat e sekretarit te KZAZ-se

Sekretari i KZAZ-së kryen këto detyra:

- a) përgjigjet për administrimin teknik dhe kushtet e punës së KZAZ-së;
- b) protokollon kërkesat, ankesat dhe njoftimet drejtuar KZAZ-së;
- c) mban dokumentacionin zgjedhor të arkivuar;
- ç) përgatit, në përputhje me udhëzimet e kryetarit, materialet për mbledhjen e KZAZ-së dhe ua shpërndan ato anëtarëve;

Përsa më sipër, është e qartë dhe e vërtetuar se Sekretari i KZAZ nr. 93 Konispol Julian Lako ka vepruar në shkelje të ligjit, konkretisht të nenit 32/a të Kodit Zgjedhor dhe ka shkelur dispozitat që lidhen me ushtrimin e detyrës, të cilat referojnë në nenin 34/a të Kodit Zgjedhor, që lidhen me përgjegjësinë për administrimin teknik.

III. Kërkesat tona specifike

Bazuar për sa më sipër kërkojmë:

1. Shkarkimin e znj. Uva Uzeir nga funksioni si nënkryetare e KZAZ nr. 93 për shkak të konfliktit të interesit.
2. Shkarkimin e z. Julian Lako nga funksioni i sekretarit të KZAZ nr. 93 dhe si Nënkyetar i Bashkisë Konispol, për shkak të mosadministrimit të duhur të vulës.
3. Hapjen e një hetimi të pavarur mbi procedurat dhe masat e sigurimit në KZAZ nr. 93.
4. Nisjen e një hetimi administrativ serioz nga Inspektorët e KQZ-së mbi të dy rastet, për të evidentuar shkeljet dhe për të propozuar masat disiplinore.
5. Kërkojmë që inspektorët e KQZ-së të monitorojnë nga afër të gjitha fazat e administrimit të materialeve zgjedhore në KZAZ nr. 93.

Ne besojmë se një vendim i tillë është i domosdoshëm për të rikthyer besimin publik në integritetin e procesit zgjedhor dhe për të ruajtur pavarësinë e administratës zgjedhore në zonën e Konispolit.

Kërkojmë që kjo kërkesë të shqyrtohet pa vonesë nga ana e KQZ-së, duke marrë në konsideratë natyrën e rëndë të shkeljeve të pretenduara dhe afërsinë kohore me zhvillimin e zgjedhjeve parlamentare të 11 majit 2025.

Me respekt,

Z. Franci NURI

Përfaqësues Ligjor pranë KQZ-së i PD-ASHM



